

VENDIM
Nr. 220, datë 1.4.2026

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “PARKU NATYROR ‘LIQENI I ULZËS’ DHE ZONA E MBROJTUR PËRRETH TIJ”, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË MAT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Parku Natyror ‘Liqeni i Ulzës’ dhe zona e mbrojtur përreth tij”, me vendndodhje në Bashkinë Mat.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Ministrisë së Mjedisit.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë”, “truall”, “njësi” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme prej 4 041 111.70 (katër milionë e dyzet e një mijë e njëqind e njëmbëdhjetë pikë shtatëdhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 4 041 111.70 (katër milionë e dyzet e një mijë e njëqind e njëmbëdhjetë pikë shtatëdhjetë) lekësh, përballohet nga buxheti i shtetit, llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Ministria e Mjedisit.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin

8. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Ministria e Mjedisit.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Mat, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Ministrisë së Mjedisit për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Ministrisë së Mjedisit për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave, Ministria e Mjedisit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Mat, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit të Tokës pranë Këshillit të Qarkut Dibër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË TË CILËVE SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT “PARKU NATYROR ‘LIQENI I ULZËS’ DHE ZONA E MBROJTUR PËRRETH TIJ”, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË MAT

Nr.	PRONARI			TË DHËNAT KADASTRALE (SI PAS KARTILËS SË PASURISË)				VLERËSIMI PËR SHIRONËSIM										SHËNIME
								TOKË TRUAJLL			TOKË ARË			NDËRTESË SOCIAL- EKONOMIKE		Vlerësimi i dufrimeve	VLERA Totale (L.EKF)	
	Sipërfaqja e shpronësuar (m2)	Cinisi (lekë/m2)	Vlera lekë	Sipërfaqja e shpronësuar (m2)	Cinisi (lekë/m²)	Vlera lekë	Sipërfaqja e shpronësuar	Vlera sipas preventivit										
	Emri	Adresa	Mbledhje	ZK	Nomeri ipashuriz	Lloji Pashuriz	Sip. totale											
1	Viktor	Dod	Lidhi	2.198,00	181/1	m²	500,00		500,00	114,00	57.000,00		508.918,00	565.918,00				
	Gjok Gjok Mark Artun Gjok Autrit Gjok		Stojan Stojan Stojan Stojan Stojan Stojan	2.198,00	181/1	m²	800,00		800,00	114,00	91.200,00			91.200,00				
3	Lila	Gjon	Rica	3.675,00	1/127ND	shtetëre	110,00			110,00	1.507.360,40		1.507.360,40					
4	Adela	Ndau	Shpani	3.675,00	1/16/NDH1- SU	njësi	59,00			59,00	1.076.255,40		1.076.255,40					
5	Radin	Gjon	Serfajni	3.675,00	1/16/NDH1- KS2	njësi	44,00					44,00	797.053,90	797.053,90				
6	Fran Edmond Bashkim Teuta Fran Albert Antea	Pjetër Fran Nikolet Fran Nikolet Fran Nikolet	Nikolet Nikolet Nikolet Nikolet Nikolet Nikolet	3.675,00	1/70/1	truall	180,00	8,00	413,00	3.304,00				3.304,00				
													VLERA TOTALE		4.041.111,70			